



KCB

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KRYETARINr. 3389/1 prot.Vlorë, më 18.02 2026**PROJEKT VENDIM**

Nr. _____, Datë, _____ 2026

“ PËR SHPREHJEN E DAKORDËSISË PËR NISJEN E PROCEDURAVE PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË VLORË ” PASURITË ME NR.29/39-ND DHE 29/39-S, ZONA KADASTRALE 8605, GODINË 3KATE , NË TË CILËN KA USHTRUAR VEPRIMTARINË ADMINISTRATIVE DVASHK VLORË ME QËLLIM GODINË SHËRBIMI.”

Bazuar në Ligjin Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” Neni 8, Neni 9.1 pika 1/b dhe 2, Neni 54 pika e, në Ligjin Nr.8743 datë 22.02.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit, i ndryshuar me Ligjin Nr. 9558/2006, në Ligjin Nr.8744 datë 22.02.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore” i azhornuar me Ligjin Nr.9561, datë 12.06.2006, si dhe me Ligjin Nr. 9797, datë 23.07.2007”, në V.K.M Nr.500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në Njësitë e Qeverisjes Vendore” ndryshuar me V.K.M Nr. 1277, datë 23.12.2009, në Udhëzimin Nr.15, datë 30.05.2003 “Për mënyrën e paraqitjes nga Njësitë e Qeverisjes Vendore të kërkesave për transferimin, në pronësi të tyre të pronave të paluajtshme publike”, në shkresën me nr. 20, datë 13.01.2026, protokolluar në Bashkinë Vlorë me nr. 10435/3, datë 14.01.2026 si edhe në relacionin bashkëlidhur këtij projektvendimi, e paraqitur nga administrata e Bashkisë:

V E N D O S I:

1. Të shprehi dakordësinë për nisjen e procedurave për transferimin në pronësi të Bashkisë Vlorë, me qëllim shërbimi, të godinës 3 (tre) kate në të cilën ka ushtruar veprimtarinë administrative DAVSHK Vlorë sipas formularit të inventarizimit për pasuritë e mëposhtme:

- Nr. 29/39-S, me sipërfaqe totale 218 m², Zk. 8605
- Nr. 29/39, Nd me sipërfaqe totale 230 m², Zk. 8605

2. Ngarkohet Kryetari, Drejtoria e Pronave Publike dhe Menaxhimit të Aseteve dhe Drejtoria e Urbanistikës, të kryejë procedurat përkatëse ligjore deri në vendimarrjen e Këshillit të Ministrave për kalimin e pronësisë sipas pikës 1.

Ky Vendim hyn në fuqi bazuar në Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 55 pika 6.

KRYETAR
Brunilda Mersini





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË

Nr. 3389/1 prot.

Vlorë, më 18.02. 2026

RELACION

MBI PROJEKTVENDIMIN “PËR SHPREHJEN E DAKORDËSISË PËR NISJEN E PROCEDURËMIRATIMIN E KËRKESËS PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË VLORË TË GODINËS 3 (TRE) KATËSHE, ZONA KADASTRALE 8605, NË TË CILËN KA USHTRUAR VEPRIMTARINË DVASHK VLORË ME QËLLIM GODINË SHËRBIMI

Para Këshillit të Bashkisë!

Të nderuar Këshilltarë,

Po ju paraqesim këtë projektvendim për shprehjen e dakordësisë për nisjen e procedurave për transferimin në pronësi të Bashkisë Vlorë, pasuritë me Nr.29/39-Nd dhe 29/39-S Zona Kadastrale 8605 Godinë 3 Kate në të cilën ka ushtruar veprimtarinë administrative DVASHK Vlorë, e cila do të përdoret nga Bashkia me qëllim godinë shërbimi”.

Qëllimi i projektvendimit:

Në kuadër të përmbushjes së detyrimeve funksionale dhe rritjes së kapaciteteve administrative të Bashkisë Vlorë, po ju paraqesim për shqyrtim dhe miratim projektvendim për shprehjen e dakordësisë lidhur me nisjen e procedurave për kalimin në pronësi të Bashkisë Vlorë të ambienteve të ish-Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK) Vlorë, të cilat aktualisht janë të lira dhe nuk ushtrojnë më funksionin e mëparshëm.

Administrata e Bashkisë Vlorë aktualisht përballet me mungesë ambientesh të përshtatshme për zhvillimin normal të veprimtarisë së saj si pasojë:

- Rritjes së volumit të shërbimeve publike
- Shtimit të strukturave funksionale në përputhje me organikën e miratuar
- Nevojës për ambiente më të aksesueshme dhe funksionale për qytetarët

Miratimi i përdorimi të këtyre ambienteve krijon kushte më të përshtatshme për ushtrimin e detyrave institucionale, rrit efikasitetin administrativ, përmirëson aksesin e qytetarëve në shërbime si dhe shmang shpenzime shtesë për marrje ambientesh me qera. Gjithashtu vlen të theksohet se ky projektvendim nuk sjell kosto shtesë të konsiderueshme për buxhetin e Bashkisë.

Sikurse jeni në dijeni, pas transferimit të Drejtorisë Vendore të ASHK Vlorë, godina 3 (tre) katëshe me numër pasurie 29/39-ND dhe numër pasurie 29/39-S, zona kadastrale 8605, është aktualisht e lirë. Duke marrë në konsideratë nevojat gjithnjë në rritje të administratës së Bashkisë Vlorë për ambiente pune, zyra funksionale dhe hapësira për ofrimin e shërbimeve publike, nga ana jonë është vlerësuar se ky objekt përbën një mundësi reale dhe të arsyeshme për t'u vënë në shërbim të të Bashkisë Vlorë.

Për këtë qëllim, me shkresën nr. 10495/1 prot., datë 17.07.2025, Bashkia Vlorë i është drejtuar zyrtarisht Agjencisë Shtetërore të Kadastrës/Drejtorisë së Pronave Publike, duke kërkuar nisjen e procedurave për kalimin në pronësi të saj të këtij objekti. Kërkesa është bazuar në faktin se godina në fjalë e ka humbur funksionin institucional për të cilin është ndërtuar dhe aktualisht është e papërdorur, ndërkohë që Bashkia Vlorë përballet me mungesë të theksuar hapësirash për ushtrimin normal të funksioneve administrative dhe publike.

Nevoja për zgjerimin dhe riorganizimin e ambienteve të Bashkisë është e lidhur drejtpërdrejt me rritjen e volumit të shërbimeve, shtimin e strukturave organizative, si dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve. Sigurimi i një godine ekzistuese, e cila mund të përshtatet për nevojat e administratës vendore, përbën një zgjidhje efikase, ekonomike dhe funksionale, në krahasim me alternativa të tjera që do të kërkonin kohë dhe burime më të mëdha financiare.

Në kuadër të procedurës ligjore për transferimin e pronësisë së një pasurie të paluajtshme shtetërore në favor të një njësie të vetëqeverisjes vendore, kërkohet miratimi me Vendim të Këshillit të Ministrave. Përpara paraqitjes së kërkesës për miratim në Këshillin e Ministrave, legjislacioni në fuqi parashikon, ndër të tjera, edhe marrjen e Vendimit të Këshillit të Bashkisë për shprehjen e dakordësisë për kalimin e pronësisë, si dhe verifikimin e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut Vlorë.

Në këtë kuptim, projektvendimi që paraqitet sot për miratim nuk nënkupton kalimin e menjëhershëm të pronësisë së pasurive me nr. 29/39-ND dhe 29/39-S në favor të Bashkisë Vlorë, por përbën një hap të domosdoshëm procedural, i cili i hap rrugë vijimit të mëtejshëm të praktikës pranë institucioneve kompetente. Janë këto institucione që do të shqyrtojnë dokumentacionin përkatës dhe do të vlerësojnë përmbushjen e të gjitha kritereve ligjore deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga Këshilli i Ministrave.

Referuar dispozitave ligjore që rregullojnë administrimin dhe transferimin e pasurive të paluajtshme, Këshilli i Bashkisë është organi kompetent për të shprehur dakordësinë për kalimin e pronësisë në favor të Bashkisë, duke qenë se bëhet fjalë për pasuri të paluajtshme që do të përdoren për funksione publike dhe administrative.

Për sa më sipër, duke vlerësuar rëndësinë që ka sigurimi i ambienteve të përshtatshme për ushtrimin e funksioneve të Bashkisë Vlorë dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj qytetarëve, kërkojmë nga ana juaj miratimin e këtij projekt-vendimi, me qëllim mundësimin e vijimit të procedurave të mëtejshme ligjore për kalimin e pronësisë nëpërmjet vendimmarrjes së Këshillit të Ministrave.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin dhe angazhimin tuaj në funksion të interesit publik!

KRYETAR
Brunilda Mersini



The stamp is circular with the text "REPUBLIKA E SHQIPËRISË" at the top and "BASHKIA VLORE" at the bottom. In the center, there is a smaller circular emblem containing a map of the region.

1. FORMULARI I PËRDITËSIMIT TË PRONËS

Bashkia: Vlore Nja Vlore

Fusha e përdorimit të Pronës: Bashkia Vlorë

Identifikoi:

Supervizori:

Aprovoi:

A.Mejdani Topograf;K.Agalliu Topograf;K.Nuredini Topograf
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
K.Kolagji, Drejtor DPPMA;Anisa Pjetri Pergjegjës DPPMA, Inqilj Xhatenaj (Drejtor Urbanistike)
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Brunilda Mersini , Kryetari i Bashkisë Vlorë
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

Nr. Rend	Zona Kadastr. & Indeksi I Hartës	Nr. Pasurisë	Lloji i Pasurisë	Emërtesa e pasurisë Adresa	Sip. Pasurisë (m ²)	Nga Sip.		Funksioni për të cilin përdoret pronë	Institucioni me përgjegjësi administrative/pronësi	Institucioni përdorues i pasurisë Statusi juridik i përdorimit	Inventarizuar me VKM	Të dhëna të fiera (Shënimet të veçanta)
						Sa t'nall (m ²)	Ndërtesë (m ²)					
1												
	8605 VL-H-11	29/39-ND	Ndërtesë 2-kate	Njësia Administrative e Vlorë	230			Përdorur nga Drejtoria Vendore e Ashk Vlorë, aktualisht jo ne funksion	Republika e Shqipërisë	Përdorur nga Drejtoria Vendore e Ashk Vlorë, aktualisht jo ne funksion	Certifikuar , zK 8605 Kodi unik 8605021078	Sipas rivevimit faktik të kryer nga Inq. Topografë , vliet re që ka diferencë dokument - fakt. Sipas faktit sipërfaqja e katit të parë është 221.67 m ² . Sipas planimetrive faktike sipërfaqe e katit të dytë është 218 m ²
	8605 VL-H-11	29/39-S	Studio	Njësia Administrative e Vlorë	218			Përdorur nga Drejtoria Vendore e Ashk Vlorë, aktualisht jo ne funksion	Drejtoria Vendore e Ashk Vlorë	Përdorur nga Drejtoria Vendore e Ashk Vlorë, aktualisht jo ne funksion	Certifikuar , zK 8605 Kodi unik 8605063212	



10495/3

14. 01. 2026

BASHKISË VLORE



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS
DREJTORIA E PRONAVE SHTETËRORE**

Nr 20 Prot.

Lënda: Kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Tiranë, më 13.01.2026

**BASHKISË VLORE
VLORE**

Për dijeni:

**AGJENCISË SHTETËRORE E KADASTRËS
ZJ. LORENA GOXHOBELLI
DREJTOR I PËRGJITHSHËM
TIRANË**

Pranë Drejtorisë së Pronave Shtetërore është administruar shkresa e Drejtorisë së Përgjithshme të Kadastrës me nr. 6116/11 prot., datë 29.12.2025, nëpërmjet të cilës, në vijim të shkresës së Bashkisë Vlorë me nr. 10495/1 prot., datë 17.07.2025, kërkohet ndjekja e procedurave për kalimin në pronësi të Bashkisë Vlorë të godinës 3 kate me numëra pasurie 29/39-nd dhe 29/39-s, zona kadastrale 8605, Vlorë, në të cilën ka ushtruar veprimtarinë administrative DVASHK Vlorë dhe aktualisht është e lirë. Pas verifikimit të dokumentacionit bashkëlidhur shkresës së sipërcituar, me qëllim vijimin e procedurës, kërkohet nga ana juaj si më poshtë vijon:

- Vendimin e Këshillit Bashkiak Vlorë, që miraton kërkesën e Bashkisë Vlorë për kalimin në pronësi të saj të pasurive me nr. 29/39-nd dhe 29/39-s, ZK 8605, godinë 3 kate, në të cilin të përcaktohet edhe destinacioni i përdorimit të pronës;
- Formularin e inventarizimit, në të cilin të identifikohen të dy numrat e pasurive të sipërcituara, si dhe të përcaktohet gjithashtu edhe destinacioni i përdorimit nga Bashkia Vlorë. Nga ana formale, formulari i inventarizimit të jetë i firmosur nga të gjithë personat përgjegjës, sipas struktues hierarkike përkatëse, si dhe i vulosur me vulën e Bashkisë;
- Relacion shpjegues, në të cilin të jepet informacion i detajuar nga ana e Bashkisë lidhur me destinacion e përdorimit të pasurive të sipërcituara, i domosdoshëm për hartimin e projektvendimit të Këshillit të Ministrave;
- Planin e Rilevimit për objektin 3 kate, në krye të të cilit të përcaktohen të dhënat kadastrale për të dyja pasuritë me nr. 29/39-nd dhe 29/39-s, ZK 8605, ndërsa në seksionin shpjegues të pasqyrohen sipërfaqet respektive për çdo kat.

Ju faleminderit për mirëkuptimin!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 8605063212
(Nga _____, Në _____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 8605, Lloji i Pasurisë: STUDIO, Nr. i Pasurisë: 29/39-S, Sipërfaqja Totale 218
m2, (Nga të Cilat Truall 0 m2; Ndërtesë 218 m2)

Indeksi i Hartës Kadastrale VL-H-11, Numri i Pemëve: 0,
Adresa e Pasurisë: Bashkia VLORA 5, Rruga _____, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____
Vlera e Pasurisë:
Fillestare _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____), Rivlerësim _____ (Akti Nr. _____, Dt. _____)

B - TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: Drejtoria Vendore e ASHK së Vlorë, Nr. Identifikimi/NIPT K67114204J, Pjesa Takuese
1/1, Lloji i Pronësisë: I

Adresa e Pronarit: Bashkia _____, Rruga L. 29 NENTORI, Ndërtesa Nr. _____, SH/K _____, Apartamenti Nr. _____

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. 00017981, Datë: 13/07/2021

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. _____, me Kod Unik _____*

B/1 - TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraparak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi i Objektit të Aktit: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT
00017981	13/07/2021		NGRIHET MBI PASURINE NR 29/39-ND, VOL 21, FAQE 78			0		

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: Të tjera, Emërtimi i Aktit: Akte të tjera sipas legjislacionit në fuqj Nr. 342,
Datë: 12/06/2019

Regjistruar: Nr. 00017981, Datë: 13/07/2021

Përshkrimi: SHTESE NE LARTESI MBI OBJEKTIN EKZISTUES DY KATE

DREJTORI
Erisad Jusufaj

Stiven
cobani

Digitally signed by:
Stiven cobani
Date: 2025.11.19
03:51:45 +02'00'

Albina
Myrtaj

Digitally signed by:
Erisad Jusufaj
Date: 2025.11.20
12:17:20 +02'00'

Digitally signed by:
Erisad Jusufaj
Date: 2025.11.20
05:14:04 +02'00'



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Vlorë
Date: 2025/11/19 15:52:53 +02'00'
K5670320102025111915524616ASHK

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrore)

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

Kodi Unik 8605021078

(Nga _____, Në _____)

A - TË DHËNAT E PASURISË

Zona Kadastrale Nr. 8605, Lloji i Pasurisë: NDERTESE, Nr. i Pasurisë: 29/39-nd, Sipërfaqja Totale 230 m²,
(Nga të Cilat Truall 0 m²; Ndërtesë 230 m²)

Indeksi i Hartës Kadastrale vl-h-11, Numri i Pemëve: 0,

Adresa e Pasurisë: Bashkia VLORË, Rruga _____, Ndërtesa Nr. __, SH/K __, Apartamenti Nr. __
Vlera e Pasurisë:

Fillestare __ (Akti Nr. __, Dt. _____), Rivlerësim __ (Akti Nr. __, Dt. _____)

B - TË DHËNAT E TITULLIT TË PRONËSISË

Pronari: Republika e Shqiperise - , Nr. Identifikimi/NIPT SG704237193, Pjesa Takuese 1/1, Lloji i Pronësisë: I

Adresa e Pronarit: Bashkia VLORË, Rruga _____, Ndërtesa Nr. __, SH/K __, Apartamenti Nr. __

Akti i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. __, Datë: _____

Regjistruar: Nr. 00016397, Datë: 05/07/2019

**Pjesëmarrës në Bashkëpronësi të Detyrueshme për Pasurinë Nr. _____, me Kod Unik _____*

B/1 - TË DHËNAT E REGJISTRIMIT PARAPRAK

Akti Paraparak i Fitimit të Pronësisë: Emërtimi: _____, Nr. __, Datë: _____

Përshkrimi i Objektit të Aktit: _____

Regjistruar: Nr. __, Datë: _____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

KARTELA E PASURISË SË PALUAJTSHME

C-TË DREJTAT REALE

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i të Drejtës	Të Dhënat e Aktit			Afati i Vlefshmërisë	Përfitues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT
00016397	05/07/2019		NE PËRGJEGJESI ADMINISTRIMI TE MINISTRISË SE DREJTËSISË , ZYRA QENDRORE E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME , PERDORUES ZVRPP,VLORE(SIPAS VKM NR 448 DATE 16.06.2005 DHE 112			0		

D - KUFIZIMET E PRONËSISË

Nr. Regjistrimi	Dt. Regjistrimi	Lloji i Kufizimit	Të Dhënat e Aktit			Afati i Kufizimit	Përfitues/Kërkues	
			Emërtim	Nr.	Datë		Emër Atësi Mbiemër	Nr. Identifikimi/ NIPT

E - INFORMACIONE TË TJERA PËR PRONËN

Lloji i Informacionit: _____, Emërtimi i Aktit: _____, Nr. _____, Datë: _____

Regjistruar: Nr. _____, Datë: _____

Përshkrimi: ndertese 2 kateshe V.K.M nr448, date 16.06.2005 DHE 112

DREJTORI
Erisad Jusufaj

Stiven
cobani

Digitally signed by:
Stiven cobani
Date: 2025.11.19
03:51:22 +02'00'

Albina
Myrtaj

Digitally signed by:
Albina Myrtaj
Date: 2025.11.20
12:15:16 +02'00'

Erisad
Jusufaj

Digitally signed by:
Erisad Jusufaj
Date: 2025.11.20
05:13:36 +02'00'



Vulosur elektronikisht nga Drejtoria
Vendore Vlorë
Date: 2025/11/19 15:52:09 +02'00'
K5670329102025111915520015ASHK

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një procedure automatike nga një sistem elektronik (Agjencia Shtetërore e Kadastrës)




REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

ZONA KADASTRALE :8605
NUMRI I PASURISË : 29/39-S

KODI UNIK:8605063212
INDEX I HARTËS :VL-H-11



SH 1:500

DREJTOR

Data e lëshimit
Albina Myrtaj

Digitally signed by:
Albina Myrtaj
Date: 2025.11.20
12:17:08 +02'00'

Erisad Jusufaj

Digitally signed by:
Erisad Jusufaj
Date: 2025.11.20
05:13:51 +02'00'

SHPJEGUES :

- PARCELA
- NDËRTESA



Vulosur elektronikisht nga Drejtorja
Vendore Vlorë
Date: 2025/11/20 12:17:54 +02'00"
K56703201020251120121747710114



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS


FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

ZONA KADASTRALE :8605

KODI UNIK:8605021078

NUMRI I PASURISË : 29/39-nd

INDEX I HARTËS :VL-H-11



SH 1:500

DREJTOR

Data e lëshimit
Albina Myrtaj

Digitally signed by:
Albina Myrtaj
Date: 2025.11.20
12:15:01 +02'00'

Erisad Jusufaj

Digitally signed by:
Erisad Jusufaj
Date: 2025.11.20
05:13:14 +02'00'

SHPJEGUES :

 PARCELA

 NDËRTESA




Vulosur elektronikisht nga Drejtorja
Vendore Vlorë
Date: 2025/11/20 12:15:58 +02'00'
K5870320102025112012195103014


Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë

PLANIMETRITË EKZISTUESE TË ASHK, VLORË


SIPËRFAQE E KATIT PËRDHE - 218 M2



SIPËRFAQE E KATIT PARË - 218 M2



SIPËRFAQE E KATIT DYTË - 218 M2



Indira Xhaderaj

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI . ASHK - Vlore DATE . 15.02.2026 QELIMI . Regjistrim Pasurie

VENDNDODHJA

VLORE

DAVSHKIZVASHK

ZONA KADASTRALE . 8605

INDEX HARTE . VL - H - 11

TE DHENAT E PASURISE

LLOJI PASURISE . Zyre SIP.PAS.TOTA SIFERFAQE GJURMES NDERTIMIT . 221.67 M2 NUMRI KATEVE 3 / Tre /


SIP.PAS.TOTA

NUMRI PEMEVE

E 455976.11
N 4481991.39

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

E 456426.08
N 4481996.48



E 455979.51
N 4481691.41

SH 1:500

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1				Rruge		
2				Shesh		
3				Pasurite Nr.29/36 - 29/2		
4				Pasurite Nr.29/3 - 29/37 ND		

REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT

EMRI: A. MEJDAH K. AGALLIU K. NUREDINI

LICENCA : NR.

DATE :

KOMPANIA :

NIPT :

NENSHKRIMI/VULA

REALIZOI PER ASHK

SPECIALISTI

DVASHK

NENSHKRIMI

KONFIRMOJ

PERGJEGJESI/DREJTORI

NENSHKRIMI/VULA

TEKNOLOGJIA E MATJEVE:

Kode per teknologjine e matjeve : T-Terren ; Z-Zyre ; O-Ortofoto ; G-Gps ; S-Station Total ; D-Matje Distancash

PERCAKTIMI I KUFIRIT :

Kode per percaktimin e kufirit : P-Perfaqesues i pronareve ; K-Kufitaret te Gjithe ; KP-Kufitaret Pjeserisht ; PB-Perfaqesues Bashkie ; HK-Harta Kadastrale ; SHENIME TE VECANTA:

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

EMRI

NENSHKRIMI

kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit : T-Terren ; Z-Zyre ; O-Ortofoto ; G-GPS ; S-Station Total ; D-Matje Distancash ; P-Perfaqesues i Pronareve ; K-Kufitaret te Gjithe ; KP-Kufitaret Pjeserisht ; PB- Perfaqesues Bashkie ; HK-Harta Kadastrale